

PROGRAMI I PUNËS SË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

JANAR – DHJETOR 2024



MIRATOI

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Hyrje

Misioni i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Zyra e Komisionerit e zhvillon veprimtarinë e saj sipas Programit të Punës, bazuar, por jo vetëm, në Rezolutën vjetore të Kuvendit, si dhe parashikimeve të tjera që gjenden në dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Zyra e Komisionerit, Programin e Punës e ka hartuar bazuar në misionin e saj dhe në pajtim me prioritetet dhe objektivat e përcaktuar, me qëllim përmbushjen sa më mirë të këtij misioni. Programi është fokusuar kryesisht në objektiva me prioritet, si dhe objektiva që realizohen në vazhdimësi, me të cilat synon fuqizimin e institucionit me qëllim të përmbushjes së plotë të misionit të saj drejt respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe promovimit, rritjes së ndërgjegjësimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Viti 2024 është një vit shumë i rëndësishëm për vendin tonë lidhur me objektivin madhor të avancimit në rrugën e integritit evropian. Mbyllja me sukses e procesit *screening* përgjatë viteve 2022 dhe 2023 u finalizua me miratimin e dy dokumenteve themelare lidhur me prioritetet e vendit në rrugëtimin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, konkretisht Udhërrëfyesi Shteti i së Drejtës dhe Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike.

Objektivat dhe masat e parashikuara në këto dokumente lidhur me fushën e përgjegjësisë së Zyrës janë ato të konsideruara më me prioritet në këtë program.

Organizuar për herë të parë në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria do të mirëpresë Konferencën e XV Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit në datat 3 – 5 qershor 2024. Ky është aktiviteti më i rëndësishëm botëror për nxitjen e kulturës së transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe do të shërbejë si një platformë për trajtimin e pikëpamjeve, sfidave dhe mundësive me partnerët e saj, me përfaqësues të botës akademike, nga organizatat e shoqërisë civile, të subjekteve mediatike, vendas e të huaj. Ky aktivitet madhor, synon që t'i japë një shtysë konkrete avancimit në këtë fushë, për respektimin e kësaj të drejte themelore individuale, si një nga faktorët kryesorë për një shoqëri demokratike funksionale. Organizimi me sukses i kësaj Konference është konsideruar objektiv me prioritet në këtë program.

Korniza ligjore sipas së cilës Zyra e Komisionerit përmbush misionin e saj është si në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 45/2022 *“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”*”;
- Ligji nr. 8137/1996 *“Për ratifikimin e Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9288/2004 *“Për ratifikimin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 49/2022 *“Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”*”;
- Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 146/2014 *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*;
- Ligji nr. 113/2018 *“Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”*;
- Ligji nr. 71/2016 *“Për kontrollin kufitar”*;
- Ligji nr. 19/2016 *“Për masat shitesë të sigurisë publike”*;
- Ligji nr. 33/2022, *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*.
- VKM nr. 144/2018 *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese”*;
- VKM nr. 145/2018 *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”*.

Aktet rregullatore mbi bazën e të cilave është organizuar puna e Zyrës së Komisionerit janë si në vijim:

- Vendim nr. 8/2024 *“Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e Strukturës, Organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar”*”.
- Rregullore e brendshme e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Zyra e Komisionerit në përputhje me Vendimin nr. 8/2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e Strukturës, Organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar””, ka këto njësi funksionale:

1. Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, e cila përbëhet nga Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës, Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave dhe Sektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik. Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit është struktura, që monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit nga autoritetet publike, si dhe të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik.
2. Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila përbëhet nga Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit, Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike. Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është struktura që monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për të mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrollues publik e privat.
3. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritit, e cila përbëhet nga Sektori Rregullator, Integritit dhe Procedurave Administrative, si dhe Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritit është struktura përgjegjëse për standardizimin e kuadrit rregullator mbi të cilin funksionon Zyra e Komisionerit.
4. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, e cila përbëhet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, si dhe Sektori i Shërbimeve dhe Financës. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës është struktura përgjegjëse për administrimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe administrative të institucionit.

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit bazohet në parimet e trajtimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës, profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit, paañësisë, transparencës, efektivitetit dhe eficiencës në garantimin e të drejtave, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Programi i Punës miratohet çdo vit brenda datës 31 janar dhe rishikohet në funksion të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit.

OBJEKTIVA ME PRIORITET

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	NJËSIA PËRGJEGJËSE	PERIUDHA	REZULTATI/PRODUKTI
Organizimi dhe zhvillimi i Konferencës së XV Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit 3 – 5 qershor 2024, në Tiranë.	<p>Hartimi i Programit të Konferencës në bashkëpunim me Komitetin e Programimit të ICIC XV.</p> <p>Hartimi i Programit të masave dhe bashkërendimi i punës për përgatitjen dhe monitorimin e zbatimit të aspekteve logjistike të Konferencës ICIC.</p> <p>Raportim periodik në Komitetin Ekzekutiv të ICIC lidhur me ecurinë e përgatitjeve të Konferencës.</p> <p>Përgatitja dhe mirëmbajtja e faqes së dedikuar të Konferencës në internet.</p> <p>Bashkërendim i punës me Sekretariatit e ICIC për bashkë-hartimin dhe dërgimin e propozimeve për projekt rezoluta apo deklarata të Konferencës ICIC.</p>	<p>Grupi i Punës ngritur me Urdhër të Komisionerit nr.195, datë 4.12.2023</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit</p> <p>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës</p> <p>Spektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë</p>	Qershor-Korrik 2024	Realizimi i Konferencës dhe të gjitha aktiviteteve të tjera që lidhen me të.

	<p>Përfundimi i të gjitha aktiviteteve post Konferencë, finalizimi i dokumenteve, sondazhit të vlerësimit, etj.</p> <p>Përgatitja e broshurave, fletëpalosjeve, video, materiale promocionale për Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit.</p>			
<p>Miratimi i legjislacionit dytësor për ligjin për të drejtën e informimit dhe për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.</p>	<p>Koordinim me strukturat përgjegjëse për hartimin e projekt - vendimit në zbatim të pikës 5 të nenit 10 të ligjit për të drejtën e informimit, i ndryshuar.</p> <p>Koordinim me strukturat përgjegjëse dhe grupin e punës së ngritur për këtë qëllim për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 33/2022 <i>“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”</i>.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit</p> <p>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritimit</p>	<p>Qershor 2024</p>	<p>Përmbushja e objektivave të parashikuar për vitin 2024 për Zyrën e Komisionerit në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030.</p> <p>Vendim i Këshillit të Ministrave për masën e shtesës për natyrë të veçantë pune dhe kriteret për përcaktimin e saj për koordinatorët për të drejtën e informimit të autoriteteve publike, e miratuar.</p> <p>Udhëzim i përbashkët i ministrit përgjegjës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi miratimin e modelit të licencës standarde, i miratuar.</p>
<p>Procedurat e brendshme për aksesin në informacion dhe të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit</p>	<p>Bashkëpunim me organet e sektorit publik në përcaktimin e të dhënave që ata disponojnë e që mund të</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Sektorin për të Dhënat e</p>	<p>Dhjetor 2024</p>	<p>Listat e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, e përcaktuar nga organet e sektorit publik.</p>

publik miratohen nga institucionet kryesore.	ofrohen në formatin e të dhënave të hapura. Bashkëpunim me organet e sektorit publik në përcaktimin e grupeve specifike për çdo kategori të të dhënave me vlerë të madhe.	Hapura dhe Konsultimin Publik Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritit		Lista e organeve të sektorit publik që kanë detyrimin për publikimin e të dhënave të hapura në portalin <i>open data</i> , e hartuar dhe publikuar. Grupet specifike për çdo kategori të të dhënave me vlerë të madhe të përcaktuara.
Forcim dhe rritje kapacitetesh i koordinatorëve dhe Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura.	Bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike lidhur me hartimin e kurrikulave mbi ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura dhe zhvillimin e trajnimeve të fushës.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës Sektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik	Dhjetor 2024	Në përmbushje të objektivave të parashikuar për vitin 2024 për Zyrën e Komisionerit në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, të gjithë koordinatoret për të drejtën e informimit të trajnuar dhe certifikuar nga ASPA dhe Komisioneri, mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura.
Përmbushja e objektivave të parashikuar për Zyrën e Komisionerit për vitin 2024 në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030 me miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale që siguron përafrimin dhe përputhshmërinë me GDPR dhe Direktivën e Zbatimit të Ligjit.	Bashkëpunim me strukturat përgjegjëse deri në finalizimin e procedurave për miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale. Miratimi i legjislacionit dytësor për zbatimin efektiv të legjislacionit të përafruar.	Kabineti Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritit	Dhjetor 2024	Kuadri ligjor i harmonizuar për mbrojtjen e të dhënave zbatohet në mënyrë të vazhdueshme dhe korrekte nga palët e interesuara të informuara, në përputhje me <i>acquis</i> dhe standardet e BE-së. Pavarësia e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është rritur në praktikë.

<p>Ngritja e kapaciteteve të përshtatshme, për stafin e Zyrës së Komisionerit, Rrjetin e Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, qytetarët si dhe kontrolluesit/përpunuesit publik dhe privat, për të siguruar zbatimin efikas të legjislacionit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p>Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për kontrolluesit publik/privat, përmes programeve edukative kushtuar të gjitha grupmoshave si: <i>(veçanërisht grupeve të prekshme më të ekspozuara).</i></p> <p>Konsolidimi i Rrjetit të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në sektorin publik/privat dhe nxitja e dialogut me ta.</p> <p>Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe trajnime mbi rolin dhe detyrat e Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p> <p>Ndërtimi i infrastrukturës për të vendosur kanalet e komunikimit ndërmjet Rrjetit të Nëpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale me Zyrën e Komisionerit.</p>	<p>Kabineti</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit</p> <p>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritimit/Spektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë</p> <p>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës</p>	<p>Dhjetor 2024</p> <p>Dhjetor 2024</p>	<p>Publiku është më i informuar për të drejtat e parashikuara në legjislacionin e përafuar pas fushatave ndërgjegjësuese</p> <p>Kontrolluesit publik/privat, përfshirë Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë gjithnjë e më të vetëdijshëm për detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Kapaciteti i rritur i stafit të Komisionerit si dhe i stafit të kontrolluesve publik/privat, në të gjithë sektorët e ngarkuar për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së.</p> <p>Krijimi dhe konsolidimi i Regjistrit të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p> <p>Standardet e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave janë rritur në mënyrë progresive në kontrollues publik dhe është përmirësuar infrastruktura e institucioneve përgjegjëse.</p>
<p>Zbatim i rregullave për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike</p>	<p>Bashkëpunim efektiv me AKEP dhe AKCESK në kuadër të garantimit të sigurisë dhe integritetit të</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Drejtoria</p>	<p>Dhjetor 2024</p>	<p>Standardet e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave janë rritur në mënyrë progresive në kontrollues publik dhe është përmirësuar infrastruktura e institucioneve përgjegjëse.</p>

	rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.	e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave		
Kremtimi i Ditës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale- 28 Janar 2024	Aktivitete për qytetarët dhe grupet e interesit në funksion të ushtrimit aktiv të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.	Kabineti/Zëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës	Janar 2024	Njohja, ndërgjegjësimi dhe promovimi në tërësi i të drejtës themelore të individit për mbrojtjen e të dhënave personale.
Kremtimi i Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim - 28 Shtator 2023.	Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për qytetarët/administratën publike me qëllim përmbushjen e të drejtës për t'u njohur me informacion publik, nëpërmjet zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit.	Kabineti/Zëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës	Shtator 2024	Njohja, ndërgjegjësimi dhe promovimi në tërësi i të drejtës themelore të individit për të drejtën e informimit.
Hartimi dhe miratimi i Raportit Vjetor 2023.	Bashkërendim institucional me qëllim mbledhjen e informacioneve dhe statistikave në lidhje me veprimtarinë vjetore institucionale. Përgatitja e Raportit Vjetor 2023 dhe depozitimi i tij në Kuvendin e Shqipërisë.	Kabineti Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritimit në koordinim me të gjitha strukturat e tjera të institucionit.	Mars 2024	Raporti Vjetor 2023, i miratuar. Rezolutë për veprimtarinë e institucionit nga Kuvendi i Shqipërisë, e miratuar.

	Prezantimi i Raportit Vjetor 2023 në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe seancë plenare.			
Zbatimi i Strategjisë Institucionale për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2022-2025.	Monitorimi i objektivave në kuadër të zbatimit të Programit të Veprimit për vitin 2023 të Strategjisë Institucionale 2022-2025.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Dhjetor 2024	Objektiva strategjike të realizuar në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
Përmbushja e objektivave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2023– 2030 (SNRAP).	Realizimi i masave të parashikuara në Programin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2023-2030 (SNRAP). Raportim pranë strukturave përkatëse përgjegjëse për monitorimin e Programit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2023-2030 (SNRAP).	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit	Dhjetor 2024	Përmbushje e masave të parashikuara për vitin 2024
Përmbushja e objektivave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Antikorrupsionin 2023-2030 (SNKK).	Realizimi i masave të parashikuara në Programin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit	Dhjetor 2024	Përmbushje e masave të parashikuara për vitin 2024.

Antikorrupsionin 2023-2030 (SNKK).

Raportim pranë strukturave përkatëse përgjegjëse për monitorimin e Programit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Antikorrupsionin 2023-2030 (SNKK).

Zbatimi i Programit të Integritetit 2022-2025 i Zyrës së Komisionerit.

Monitorimi i Programit të Integritetit 2022-2025 i Zyrës së Komisionerit.

Zyra e Komisionerit

Dhjetor 2024

Raport Vjetor monitorimi i Programit të Integritetit 2022-2025.

Hartimi i raportit të monitorimit për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve dhe masave që duhet të merren nga grupi i punës i Programit të Integritetit, për të realizuar secilin aktivitet.

OBJEKTIVA NË VAZHDIMËSI

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT				
OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	NJËSIA PËRGJEGJËSE	PERIUDHA	REZULTATI/PRODUKTI
<p>Përditësimi/funksionalizimi i Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të autoriteteve publike, Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPMI), në portalin pyetshtetin.al dhe Sistemit të Menaxhimit të Aplikimit (AMS) në portalin unik qeveritar e-Albania.</p>	<p>Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës të Rishikuar sipas Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, i ndryshuar, të Komisionerit.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës</p>	<p>I vazhdueshëm</p>	<p>Të gjitha autoritetet publike qendrore/varësie të monitoruara.</p>
	<p>Zhvillimi i seancave dëgjimore. Hartimi i akteve përfundimtare.</p>			<p>Të gjitha NJVV të monitoruara</p>
	<p>Monitorimi i zbatimit të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018, të Komisionerit.</p>			<p>Funksionalitet në rritje të portalit pyetshtetin.al</p>
	<p>Monitorimi i zbatimit të përmbajtjes së “Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”, sipas Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 të Komisionerit.</p>			<p>Bazuar në procesin e monitorimeve online, deri në 10 % të totalit të AP të inspektuara.</p>
	<p>Hartimi i Indeksit të Transparencës së AP qendrore dhe të varësisë dhe NJVV.</p>			<p>Vendime/Rekomandime.</p>
	<p>Instalimi i REKPMI nga Zyra e Komisionerit në 25 autoritete të reja publike, duke e çuar në 247 numrin total të institucioneve që e kanë funksional atë.</p>			

	Përditësim i portalit pyetshtetin.al me informacion.			
	Përditësimi i listës dhe emërtimeve të AP në portal.			
	Lidhja me link-un e programit të transparencës së AP.			
	Përditësim i kontakteve dhe të dhënave të koordinatorëve.			
Zhvillimi i proceseve të rregullta të vlerësimit të ankesave dhe zhvillimit të procedurës së trajtimit të tyre, në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit.	Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave. Zhvillimi i seancave dëgjimore. Zhvillimi i inspektimeve pranë autoriteteve publike. Ndjekja e çdo çështje nga inspektorët. Pjesëmarrja në proceset gjyqësore, përfaqësimi dhe ndjekja e çështjeve në gjykatë.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave	I vazhdueshëm	Garantim aksesi në informacion publik për qytetarët. Krijim i jurisprudencës në këtë fushë. Ankesa të trajtuara. Vendime. Trend në rritje i vendimeve të Komisionerit të lëna në fuqi nga gjykatat.
Forcimi i kapaciteteve të administratës publike për aksesin në informacion dhe transparencën proaktive.	Komunikim i vazhdueshëm me përfaqësues të AP qendrore dhe NJVV, si dhe me koordinatorët për të drejtën e informimit, mbi programin e transparencës dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për të drejtën e informimit, i ndryshuar. Zhvillimi i takimeve/trajnimeve.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës	I vazhdueshëm	Zbatim më efektiv i legjislacionit për të drejtën e informimit, i ndryshuar. Kapacitete të rritura të koordinatorëve, si dhe nëpunësve të administratës publike. 25 koordinatorë për të drejtën e informimit të trajnuar për mënyrën e përdorimit të REKPDII.

	Trajnimi i 25 koordinatorëve për të drejtën e informimit për mënyrën e përdorimit të REKPDI.				
	Organizimi i Ditës së Transparencës pranë Autoriteteve Publike.				
Promovimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.	Aktivitet ndërgjegjësues me grupet e interesit mbi të drejtat që burojnë nga ligji nr.33/2022. Aktivitet ndërgjegjësues me organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike mbi detyrimet që burojnë nga ligji nr.33/2022. Realizimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi ligjin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. Kryerja e procedurave të hetimit administrativ deri në finalizimin e tyre.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Spektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik	I vazhdueshëm	Qytetarë dhe grupet e interesit të ndërgjegjësuar mbi të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr.33/2022. Vendime.	
Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.	Shqyrtimi i ankesave. Zhvillimi i seancave dëgjimore. Bashkëpunim me institucionet dhe shoqërinë civile	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Spektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik.	I vazhdueshëm	Vendime.	

Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për qytetarët në lidhje me të drejtat që u burojnë nga legjislacioni për të drejtën e informimit.	Zhvillimi i sesioneve informuese në institucione arsimore parauniversitare dhe universitare. Zhvillimi i aktiviteteve informuese me grupe interesi. Përgatitja e <i>Newsletter</i> mujor “ <i>E drejta për informim</i> ”.	Zëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës	I vazhdueshëm	Trajnime të zhvilluara me nxënës/studentë dhe staf akademik/administrativ. Rritje e kërkesave të qytetarëve për të drejtën e informimit. <i>Newsletter</i> mujor i publikuar. Video, broshura, fletëpalosje të publikuara, materiale promociionale etj.
--	--	--	---------------	--

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	NJËSIA PËRGJEGJËSE	PERIUDHA	REZULTATI/PRODUKTI
Monitorimi i zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.	<p>Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave nga qytetarët/subjekte të të dhënave personale.</p> <p>Zhvillimi i hetimeve administrative mbi bazë ankese për verifikimin e mëtejshëm pranë kontrolluesit.</p> <p>Zhvillimi i seancave dëgjimore.</p> <p>Hartimi i akteve përfundimtare.</p> <p>Pjesëmarrja në proceset gjyqësore, përfaqësimi dhe ndjekja e çështjeve në gjykatë.</p> <p>Regjistrimi ose përditësimi i formularit të njoftimit në Regjistrin Elektronik të Kontrolluesve.</p>	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit	I vazhdueshëm	<p>Minimizimi i shkeljeve, respektimi i privatësisë dhe përpunimi i drejtë dhe i ligjshëm i të dhënave personale.</p> <p>Rekomandime/Vendime/Urdhra.</p> <p>Trend në rritje i vendimeve të Komisionerit të lëna në fuqi nga gjykatat.</p>
Garantimi i hartimit të legjislacionit të brendshëm në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale me synim garantimin e parimeve dhe standardeve të BE-së në këtë fushë.	<p>Analizimi i projekt-akteve ligjore dhe nënligjore të ardhura për mendim pranë institucionit.</p> <p>Dhënia e mendimeve për projektaktet ligjore dhe nënligjore si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrollues publik dhe që përfshijnë të dhëna personale.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit</p> <p>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun.</p>	I vazhdueshëm	<p>Mendime dhe opinione ligjore.</p> <p>Sugjerime konkrete mbi zbatimin e projekteve si dhe mbi aspekte për t'u përmirësuar lidhur me to, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale</p> <p>Publikimi i dhënies së mendimeve mbi projektaktet e paraqitura në faqen zyrtare <i>web</i> të institucionit www.idp.al.</p>

<p>Garantim i mbrojtjes së të dhënave personale gjatë procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave.</p>	<p>Trajtimi i praktikave të kërkesave për autorizim të transferimit, të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit.</p> <p>Përgatitja e akteve paraprake dhe përfundimtare që kanë lidhje me shqyrtimin e praktikës së transferimit ndërkombëtar.</p> <p>Orientim dhe dhënie opinioni ligjor në lidhje me transferimin ndërkombëtar.</p> <p>Identifikimi i subjekteve që realizojnë transferim ndërkombëtar dhe realizimi i hetimeve administrative në këta kontrollues.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit</p>	<p>I vazhdueshëm</p>	<p>Vendime për dhënie apo refuzim autorizimi, si dhe orientimi i kontrolluesve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore.</p>
<p>Garantimi i zbatimit të legjislacionit për masat shtesë të sigurisë publike lidhur me regjistrimin e kontrolluesve subjekt të këtij legjislacioni.</p>	<p>Përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit të subjekteve në zbatim të ligjit për masat shtesë të sigurisë.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit</p>	<p>I vazhdueshëm</p>	<p>Zbatimi efektiv i legjislacionit për masat shtesë të sigurisë publike.</p>
<p>Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe forcim kapacitetesh me fokus prezantimin e parimeve dhe standardeve të BE lidhur me të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesve.</p>	<p>Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere:</p> <ul style="list-style-type: none"> - me organet ligjzbatuese me qëllim prezantimin e tyre me risitë që sjell Direktiva e Policisë, si pjesë integrale e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe detyrimeve të parashikuara në marrëveshjen me Eurojust; - mbi zbatimin dhe respektimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të përpunimit të të dhënave të pasagjerëve PNR/API; - me fokus sistemin e arsimit parauniversitar dhe aktorët e përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve viktime dhe/ose në kontakt/konflikt me ligjin; 	<p>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit</p>	<p>I vazhdueshëm</p>	<p>Kontrollues të sektorëve të ndryshëm, të ndërgjegjësuar dhe të trajnuar mbi risitë e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Garantimi i respektimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe mbrojtja e privatësisë nga organet dhe agjencitë ligjzbatuese.</p> <p>Promovimi i legjislacionit të ri të fushës në sistemin arsimor të vendit, me programe të dedikuara për të gjitha grupmoshat, veçanërisht, për fëmijët dhe të rinjtë.</p>

